



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 62, datë 06.09.2018

PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A SARANDË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Sarandë për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Sarandë me NUIS J64228814D është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 40 datë 11.12.2013 "Për rinovim licence Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Sarandë" e vlefshme deri më datë 13.06.2016.
- Shoqëria me shkresë nr. 364 prot. të datës 11.07.2018 ka aplikuar pranë ERRU për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës. Me shkresë nr. prot. 375 datë 26.07.2018 janë bërë plotësimet përkatëse në dosjen e aplikimit pas mangësive që kishte.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Sarandë plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:
 - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Ujësjetllës Kanalizime sh.a Sarandë ofron shërbim edhe në disa fshatra të bashkisë Finiq deri në përfundim të kalimit faktik të aseteve.

- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime sh.a Sarandë detyrohet të njoftojë ERRU pasi të ketë përfunduar procesin e kalimit faktik të aseteve të bashkisë Finiq.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës Kanalizime sh.a Sarandë me:
Drejtues Ligjor Sheme Lulo
Drejtuesit Teknik Eljon Mahmutaj
2. Operatori Ujësjiellës Kanalizime sh.a Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është si më poshtë:
 - Bashkia Sarandë
 - Bashkia Finiq (pjesërisht):

| | |
|----------------------|---|
| Nj. Admin. Finiq | Fshati Vrion |
| Nj. Admin. Aliko | Fshatrat Aliko, Çaush, Neohor, Tremul |
| Nj. Admin. Dhiver | Fshati Navaricë |
| Nj. Admin. Mesopotam | Fshatrat Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë |
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI